

## FORUM DISKUTIMI

### **Viktimat e krimit të organizuar në Shqipëri: Nevojat dhe sfidat për mbështetjen dhe parandalimin e viktimave**

**22 SHKURT 2022, ora 12:00 – 13:00**

**Vendi: Hotel Oxford (dhe online nëpërmjet Zoom)**

### Programi

Diskutimi mbi krimin e organizuar në Shqipëri është përqendruar tradicionalisht në aktivitetet e grupeve të organizuara kriminale dhe marrëdhëniet e tyre me politikën dhe biznesin. Ndërsa këto janë me të vërtetë tema të rëndësishme diskutimi, ndikimi shoqëror i aktiviteteve të grupeve të organizuara kriminale është po aq i rëndësishëm. Nëse kërkojmë të përforcojmë mbrojtjen shoqërore ndaj krimit të organizuar, duhet të diskutojmë sfidat për të ofruar mbështetje për viktimat e krimit të organizuar, si dhe të mendojmë për strategjitë e mundshme për të parandaluar rekrutimin e personave në rrezik për t'iu bashkuar radhëve të grupeve të organizuara kriminale.

Për të shënuar Ditën Evropiane për Viktimat e Krimit, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim organizon këtë forum për të diskutuar nevojat dhe sfidat aktuale për mbështetjen e viktimave dhe parandalimin e rekrutimit nga krimi i organizuar në komunitetet vulnerabël. Ky aktivitet është pjesë e një përpjekjeje më të gjerë rajonale – së bashku me partnerë të tjerë të Ballkanit Perëndimor të rrjetit të [Radarit të Krimit të Organizuar](#) – për të ndërmarrë një fushatë ndërgjegjësimi mbi gjendjen e viktimave të krimit të organizuar dhe për të trajtuar nevojat e tyre. Forume të ngjashme do të zhvillohen njëkohësisht në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo përpjekje rajonale mbështetet nga Ambasada e Norvegjisë në Serbi, Ambasada e Holandës në Serbi, si dhe Balkan Trust for Democracy.

Folësit e këtij paneli janë:

**Znj. Mariana Meshi**, drejtore ekzekutive e organizatës jo-fitimprurëse [Different and Equal](#). Mariana është një profesioniste me përvojë të gjerë në adresimin e çështjeve të trafikimit dhe shfrytëzimit në Shqipëri, madje ka punuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me viktimat e trafikimit, për t'i mbrojtur dhe ndihmuar ata nëpërmjet strehimit, ndihmës mjekësore dhe ligjore, mbështetjes psikologjike, dhe riintegrit të tyre.

**Z. Julian Kasapi**, gazetar me përvojë të gjerë i cili aktualisht punon si reporter i aktualitetit pranë televizionit A2CNN dhe ndjek zhvillimet e kronikës së zezë dhe çështjeve të sigurisë. Juliani është gazetari i parë shqiptar që kontaktoi dhe intervistoi shqiptarët në kampin Al-Hawl në Siri. Ai është edhe autori i reportazhit "[Lumi i Kokainës](#)" i xhiruar në Ekuador.



Kingdom of the Netherlands

**B | T | D** The Balkan Trust  
for Democracy  
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND



Norwegian Embassy  
Belgrade

\*Ky forum do të mbahet në një modalitet hibrid (fizikisht dhe nëpërmjet zoom). Ju lutemi ndiqni linkun për të marrë pjesë në këtë diskutim:

<https://us02web.zoom.us/j/82391158696?pwd=UjF6UytrNkIjTVhYOwYWMYVmNzZz09>. Meeting ID: 823 9115 8696 Passcode: 509604

Koha	Aktiviteti
11:45-12:00	Regjistrimi në Zoom
12:00-12:45	Diskutimi  <u>Moderator:</u> Romario Shehu, Hulumtues dhe Koordinator Programi, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim  <u>Diskutuesit:</u> <ul style="list-style-type: none"><li>- Znj. Mariana Meshi, Drejtore Ekzekutive, Different and Equal</li><li>- Z. Julian Kasapi, Gazetar, A2CNN</li></ul>
12:45-13:00	Pyetje dhe Përgjigje